

**S T A T U T I**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ACHERNAR” shpk**

**KREU I-re**

**Dispozita te Pergjitheshme**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“ACHERNAR” shpk** eshte themeluar sipas aktit te themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruar nga Ortaku i Vetem Themelues:

Z. Florian Selmanaj, lindur ne Lushnje, Shqiperi, me date 04.07.1978, shtetas Shqipetar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjofitimit me nr. 036028634, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe ne Legjislacionin shqiptar ne per gjithesi, person juridik i mesiperm eshte Ortaku i Vetem si me poshte:

**NENI 1.**

Emertimi i shoqerise eshte **“ACHERNAR” SHPK** Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi te themeluesve te saj.

Ajo rregullon poziten juridike te themeluesit dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria **“ACHERNAR” SHPK** eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet: **SHOQERIA TREGETARE ACHERNAR SHPK.**

**NENI 2.**

Shoqeria **“ACHERNAR” shpk** zhvillon aktivitetin e saj ne fushen e:

Projektim dhe realizim te programeve formuese dhe te zhvillimit te burimeve njerezore; Promovimin e aktiviteve me karakter publicitar dhe te marredhenieve me publikun, organizimin e manifestimeve dhe te koferencave, perfshire te gjitha sherbimet qe kane te bejne me to; Konsulence tregtare dhe organizative ne te gjitha format dhe ne te gjithe sektoret e aktiviteve si ne Shqiperi edhe jashte saj; Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytezimit te te gjitha instrumentave, perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera e marketingut te drejtperdrejte; Projektimi, realizimi dhe shit-blerja e sherbimeve te call center, si inbound telematike informatike dhe te marketingut, ne fushen telefonike, informatike dhe tregtare; Administrimi dhe tregtimi i bankave te te dhenave te finalizuara per marketing; Perfaqesimin dhe sherbime ne fushen e telekomunikacioneve dhe te prodhimeve e sherbimeve telematike; Projektim dhe realizim i software dhe/ose hardware, tregtimi dhe dhenia me qira e tyre, si edhe asistenca per shqyrtim. Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme shqiptare ose te huaja qe deshirojne te ushtrojne aktivitetin e tyre ne Shqiperi. Te gjitha aktivitetet e lartpermendura mund te zhvillohen si ne tregun vendas, ashtu dhe ate nderkombetar. Ajo mund te ushtroje cdo aktivitet industrial tjeter te dobishem ne drejtim te favorizimit dhe sigurimit te nje mbarevajtjeje te rregullt te prodhimit dhe mund te kryeje ne per gjithesi, te gjitha veprimet industriale, tregtare, financiare, transferimin e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme te lidhura me aktivitetin e shoqerise. Marrje dhe dhenie te sendeve te paluajtesheme dhe/ose te sendeve te luajteshme me qira.

**NENI 3.**

Shoqeria ka Selin e saj ne: Njesia Administrative Nr. 9, Rruga Panorama, Nd. 10;12, kati perdhe, kati 1, Tirane, Shqiperi.

Ajo mund te cele filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.



#### NENI 4.

Shoqeria per gjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.

#### KREU II-te

##### Te drejtat dhe detyrat e Ortakut

#### NENI 5.

##### Ortaku gezon keto te drejta kryesore:

- Pjesmarjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne aktin e themelimit dhe statutin e saj.
- Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjithe dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike, etj.
- Te marre pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijoen nepermjet perfaquesuesve te tij ose nga ata vete.
- Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjithe dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- Te bej propozime dhe t'i paraqes ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeroje dhe te shkarkoje perfaquesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

#### NENI 6.

##### Ortaku ka keto detyrime kryesore:

- Te depozitoje kuoten e tij dhe kuoten suplementare ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin.
- Te marre pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.
- Te kryej detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
- Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

#### KREU III-te

##### Kushtet Ekonomike

#### NENI 7.

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverbise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit finanziar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

#### NENI 8.

Llogarite vjetore, inventari, raportet, operacionet e veprimtarise se vitit finanziar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i rregjistruar miratohen nga Ortaku i Vetem Themelues. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit finanziar.

#### NENI 9.

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

#### NENI 10.

Kapitali i Shoqerise eshte ne shumen 100,000 (nje qind mijë) Lek, ne pronesi 100 % nga Ortaku i vetem themelues, Z. Florian Selmanaj, 1 (nje) kuote me vlere 100,000 (njeqind mijë) Lek.

#### NENI 11.

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e merr Ortaku. Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si

edhe fonde e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj, perfithen prej Ortakut te Vetem te kesaj shoqerje plus interesat si rezultat i investimit te tij. Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

#### **NENI 12.**

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdonimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen. Shoqeria gezon te drejtat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjisacionin shqiptar.

#### **NENI 13.**

E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbritet amortizimi i te gjithe pasurise se luajteshme e te palujteshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e per gjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, i takojne ortakeve themelues te saj.

#### **KREU IV-te**

##### **NENI 14**

Ortaku i Vetem merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise

##### **Kompetencat ekzekutive te tij jane:**

1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne objektin e veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
5. Percaktimi i struktures se aparatit te shoqerise.
6. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese.
7. Emerimi dhe zevendesimi i Administratoreve te per gjithshem te shoqerise.
8. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektivave te shoqerise.
9. Percaktimi i madhesise se kuotave per formimin e kapitalit baze te shoqerise.
10. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dhe perfitim nga fonde e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
11. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre.
12. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
13. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
14. Per zgjedha e antareve per komisionin e likujdimit te cilet emrohen dhe revokohen prej tij.
15. Marrjen e vendimit per marje huaje, kredi, venie si garanci hipotekore.

##### **NENI 15.**


Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga administratori i saj. Ne shoqerine **"ACHERNAR" shpk** administrator i shoqerise do te jete :

Z. Florian Selmanaj, lindur ne Lushnje, Shqiperi, me date 04.07.1978, shtetas Shqipetar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. 036028634, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Administrator emerohet per nje kohezgjatje prej pese vitesh. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

##### **Kompetencat e administratorit ne shoqeri jane:**

1. Organizojne punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raportojne per to ne perputhje me programet e planet e per gjithshme si dhe administron pasurine e shoqerise .



2. Drejton dhe kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.
3. Raporton dhe i perpjigjet Ortakeve per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.
4. Siguron drejtimin e shoqerise.
5. Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pavec ceshtjeve qe kerkojne domosdoshmerisht vendimin e Ortakut te Vetem ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Ortakut te Vetem.
6. Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Ortakut te Vetem.

#### **NENI 16.**

##### ***Marrheniet e punes ne shoqeri.***

Marrheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjizacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjizacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes. Mbi kete baze shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

#### **KREU V-te**

##### **Mbyllja e Shoqerise:**

#### **NENI 17.**

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin te ortakeve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortaku heq dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Afat i veprimtarise se shoqerise caktohet e pakufizuar.

#### **NENI 18.**

##### **Kur shoqeria likujdohet:**

Ortaku i Vetem emeron likujdatorin, te cilit i paraqitet bilanci dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij rapporti te hartuar. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

#### **NENI 19.**

Kjo Shoqeri mund te riorganizohet nepermjet bashkimit me nje shoqeri tjeter, nepermjet ndarjes ne dy apo ne shume shoqeri te tjera ose nepermjet shnderimit te formes Ligjore.

Shoqeria mund te riorganizohet vetem pasi ka qene e regjistruar per te pakten 1 vit.

Bashkimi i Shoqerive kryhet ne perputhje me dispozitat per mbrojtjen e konkurencës.


#### **NENI 20.**

Per cdo pike qe nuk parashikohet ne kete statut do ti referohemi Ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare"

Ku statut hyn ne fuqi menjehere.

Date 28.10.2020

ACHERNAR SHPK  
ORTAKU I VETEM THEMELUES



Florian Selmanaj

